

Ministria e Arsimit, Shkencës,
Teknologjisë dhe Inovacionit

RAPORT VJETOR STATISTIKOR
ME TREGUES ARSIMORË

2024/25



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Raport vjetor statistikor me tregues arsimorë 2024-2025

Prishtinë
Dhjetor, 2025

Hartuar nga:

Në hartimin e këtij publikimi, përveç stafit të Divizionit për Administrimin e Platformave Digjitale në Arsim, kanë kontribuar edhe zyrtarë nga divizione të tjera brenda MASHTI-t si dhe nga institucione partnere.

Në kapitujt “*Qasja dhe pjesëmarrja*”, “*Kushtet e mësimnxënies*” dhe “*Efikasiteti i brendshëm*” kanë punuar: Enver Mekolli, Hazbije Lahi, Leon Shabani dhe Veton Alihajdari nga Divizioni për Administrimin e Platformave Digjitale në Arsim në MASHTI.

Në llogaritjen e indikatorëve për “*Burimet financiare*”, përveç të lartpërmendurve, kanë kontribuar edhe: Halim Kastrati dhe Mevlide Shamolli nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe Advie Uka nga ASK.

Ndërsa në përpunimin e të dhënave të rezultateve të testeve të vlerësimit të jashtëm ka kontribuar Fatmir Elezi nga Divizioni për Sigurim të Cilësisë, Standarde, Vlerësim dhe Licencim në MASHTI.

Përmbajtja

1. Qasja dhe pjesëmarrja.....	8
1.2 Qasja në arsimin fillor	10
1.3 Pjesëmarrja në arsimin fillor	10
1.4 Pjesëmarrja në arsimin e mesëm të ulët	11
1.5 Pjesëmarrja në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët	12
1.6 Pjesëmarrja në arsimin e mesëm të lartë	13
1.7 Pjesëmarrja në arsimin e mesëm të lartë - profesional, sipas fushës.....	14
1.8 Fëmijët jashtë shkollës	15
2. Kushtet e mësimnxënies	16
2.1 Raporti nxënës-mësimdhënës.....	16
2.2 Raporti nxënës-paralele.....	17
2.3 Përqindja e mësimdhënësve femra.....	17
2.4 Indeksi i barazisë gjinore.....	18
3. Efikasiteti i brendshëm	19
3.1. Raporti i nxënësve që fillojnë klasën e parë dhe arrijnë në klasën e pestë në arsimin fillor.....	19
3.2. Raporti i nxënësve që fillojnë klasën e gjashtë dhe arrijnë në klasën e nëntë të arsimit të mesëm të ulët.....	19
3.3. Shkalla e kalimit (mbijetesës) sipas klasave në arsimin fillor	20
3.4. Përsëritësit në arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë	21
3.5. Shkalla e tranzicionit nga arsimi fillor në atë të mesëm të ulët.....	22
3.6. Shkalla e tranzicionit nga arsimi i mesëm i ulët në atë të mesëm të lartë	22
3.7. Nxënësit braktisës në arsimin fillor.....	23
3.8. Nxënësit braktisës në arsimin e mesëm të ulët.....	23
3.9. Nxënësit braktisës në arsimin e mesëm të lartë.....	24
3.10. Rezultatet e testeve të vlerësimeve të jashtme	25
4. Burimet financiare	26
4.1. Shpenzimet publike në arsim	27
Bibliografia	28
Shtojca 1: Të dhënat statistikore	28
Shtojca 2: Vlerësimi i jashtëm	29

Shkurtesat

ASK	Agjencia e Statistikave e Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
IP	Institucioni parashkollor
ISCED	International Standard Classification of Education/ Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
SHBR	Shkalla Bruto e Regjistrimit
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

Lista e figurave

Figura 1: SHBR në arsimin parashkollor (0-2 vjeç)	8
Figura 2: SHBR në arsimin parashkollor dhe parafillor (0-5 vjeç)	8
Figura 3: SHBR në arsimin parashkollor dhe parafillor (mosha 3-5 vjeç)	9
Figura 4: SHBR në arsimin parafillor (mosha 5 vjeç)	9
Figura 5: Shkalla e pranimit të nxënësve fillestarë	10
Figura 6: SHBR në arsimin fillor	10
Figura 7: SHBR në arsimin fillor, krahasim (viti shkollor 2024-2025)	10
Figura 8: SHBR në arsimin e mesëm të ulët	11
Figura 9: SHBR në arsimin e mesëm të ulët, krahasim (viti shkollor 2024-2025)	12
Figura 10: SHBR në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët	12
Figura 11: SHBR në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët, krahasim (viti shkollor 2024-2025)	13
Figura 12: SHBR në arsimin e mesëm të lartë	13
Figura 13: SHBR në arsimin e mesëm të lartë, krahasim (viti shkollor 2024-2025)	14
Figura 14: Nxënës të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë-Profesional sipas ISCED-F fushës së studimit	14
Figura 15: Fëmijët jashtë shkollës në arsimin e obliguar	15
Figura 16: Raporti nxënës-mësimdhënës	16
Figura 17: Raporti nxënës-paralele	17
Figura 18: Përqindja e mësimdhënësve femra	17
Figura 19: Indeksi i barazisë gjinore për SHBR	18
Figura 20: Raporti i nxënësve që fillojnë klasën e parë dhe arrijnë në klasën e pestë në arsimin fillor	19
Figura 21: Raporti i nxënësve që fillojnë klasën e gjashtë dhe arrijnë në klasën e nëntë në arsimin e mesëm të ulët	20
Figura 22: Shkalla e kalimit sipas klasave (mbijetesës) në arsimin fillor	20
Figura 23: Shkalla e përsëritjes në arsimin e mesëm të ulët	21
Figura 24: Shkalla e përsëritjes në arsimin e mesëm të lartë	21
Figura 25: Shkalla e tranzicionit nga arsimit fillor në atë të mesëm të ulët	22
Figura 26: Shkalla e tranzicionit nga arsimit i mesëm i ulët në atë të mesëm të lartë	22
Figura 27: Përqindja e nxënësve që kanë braktisur arsimin fillor	23
Figura 28: Përqindja e nxënësve që kanë braktisur arsimin e mesëm të ulët	23
Figura 29: Përqindja e nxënësve që kanë braktisur arsimin e mesëm të lartë	24
Figura 30: Rezultatet e kalueshmërisë nga testi i maturës për mësimin në gjuhën shqipe, gjuhën boshnjake dhe gjuhën turke për afatin e qershorit dhe afatin e gushtit, për vitin shkollor 2024-2025 (në përqindje)	25
Figura 31: Rezultatet e kalueshmërisë nga testi i maturës për afatin e qershorit dhe afatin e gushtit për vitin shkollor 2024-2025 (në përqindje)	25

Figura 32: Rezultatet e arritshmërisë nga testi i klasës së 9-të për vitin shkollor 2024-2025 (në përqindje).....	26
Figura 33: Shpenzimet publike për arsim si përqindje e BPV (krahasim)	27
Figura 34: Shpenzimet publike për arsim si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme të Qeverisë (krahasim)	27

Lista e tabelave

Tabela 1: Nxënësit sipas klasave në Kosovë 2024-2025	29
Tabela 2: Rezultatet e arritshmërisë sipas lëndëve nga testi i maturës për mësimin në gjuhën shqipe, viti shkollor 2024-2025.....	30
Tabela 3: Rezultatet e kalueshmërisë nga testi i maturës për afatin e qershorit dhe afatin e gushtit, viti shkollor 2024-2025.....	30
Tabela 4: Rezultatet e testit të arritshmërisë, klasa e 9-të.....	30

Hyrje

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), përmes Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA), ofron të dhëna statistikore që pasqyrojnë gjendjen aktuale dhe trendet e arsimit në Kosovë, të cilat shërbejnë si bazë për orientimin e politikave arsimore.

Që nga viti 2015, MASHTI ka përgatitur dhe publikuar raporte vjetore statistikore me tregues arsimorë. Raporti i parë i këtij lloji, i titulluar “Raporti statistikor me tregues arsimorë 2014/15”, shënoi një hap të rëndësishëm në zhvillimin e monitorimit sistematik të arsimit në vend. Raportet vjetore pasuese janë publikuar në uebfaqen zyrtare të MASHTI-t dhe vazhdojnë të jenë të aksesueshme për publikun.

Publikimi i raporteve statistikore nga sektori i SMIA-s ka nisur që në vitin 2008 dhe është zhvilluar vazhdimisht, duke u pasuruar me të dhëna dhe tregues të rinj.

Kalkulimi i treguesve të përfshirë në këtë raport është kryer sipas strukturës dhe metodologjisë së përcaktuar në Kornizën e Treguesve të Arsimit në Kosovë (2017), e cila është rezultat i rishikimit të Kornizës së vitit 2010 dhe përfshin tregues të shtuar e të përditësuar.

Në kuadër të përpjekjeve për qëndrueshmëri dhe standardizim të raportit vjetor statistik, edhe këtë vit është përgatitur publikimi i ri: “Raporti vjetor statistikor me tregues arsimorë 2024–2025”.

Ky raport është në përputhje me Kornizën e Treguesve Arsimorë në Kosovë dhe përbëhet nga katër kapituj kryesorë:

1. Qasja dhe pjesëmarrja;
2. Kushtet e mësimnxënies;
3. Efektiviteti i brendshëm;
4. Burimet financiare.

Për llogaritjen e treguesve janë përdorur të dhëna nga Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), si dhe nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Për të ofruar një pasqyrë më të qartë mbi zhvillimet në sektorin e arsimit në Kosovë, raporti përfshin edhe krahasime me disa shtete të rajonit dhe të Evropës.

Një sfidë e vazhdueshme mbetet grumbullimi i të dhënave statistikore për shkollat me mësim në gjuhën serbe.

Për llogaritjen e treguesve të arsimit në këtë raport janë përdorur të dhënat e popullsisë sipas moshës (ose grupmoshës) nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2024, Prishtinë, dhjetor 2024.


Raportin vjetor statistikor me tregues arsimorë 2024–2025 mund ta gjeni në uebfaqen zyrtare të MASHTI-t. <http://masht.rks-gov.net>.

1. Qasja dhe pjesëmarrja

Për matjen e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe nxënësve në arsimin parauniversitar, ky kapitull paraqet treguesit arsimorë që lidhen me shkallën bruto të regjistrimit në nivelet e mëposhtme të shkollimit: edukimi parashkollor (mosha 0–2 vjeç), arsimi parafillor (mosha 5 vjeç), arsimi fillor (klasat 1–5), arsimi i mesëm i ulët (klasat 6–9) dhe arsimi i mesëm i lartë (klasat 10–12).


1.1. Pjesëmarrja në arsimin parashkollor dhe parafillor

Figura 1: SHBR në arsimin parashkollor (0-2 vjeç)¹



Grafikoni tregon se SHBR në arsimin parashkollor për moshën 0–2 vjeç është e ulët, me 7.7% për meshkujt dhe 8.2% për femrat. Totali prej 8.0% tregon një përfshirje të kufizuar të fëmijëve në këtë nivel.


Figura 2: SHBR në arsimin parashkollor dhe parafillor (0-5 vjeç)



Gjatë vitit shkollor 2024/2025, përqindja totale e fëmijëve të moshës 0–5 vjeç të përfshirë në arsimin parashkollor dhe parafillor (SHBR) arriti në 25.9%, duke shënuar një rritje prej 5.5 pikë përqindjeje krahasuar me 20.4% të regjistruar në vitin shkollor 2023/2024.


¹ Në institucionet parashkollore publike nuk ofrohen shërbime për fëmijët nën moshën 1 vjeçare

Figura 3: SHBR në arsimin parashkollor dhe parafillor (mosha 3-5 vjeç)



Sipas të dhënave për vitin shkollor 2024/2025, shkalla bruto e regjistrimit (SHBR) në këtë nivel arriti në 43.4%. Krahasuar me vitin 2023/2024, kur SHBR ishte 36.8%, kjo paraqet një rritje prej 6.6 pikë përqindjeje.

Figura 4: SHBR në arsimin parafillor (mosha 5 vjeç)




Shkalla bruto e regjistrimit (SHBR) për këtë grupmoshë në vitin shkollor 2024/2025 është 87.1% për totalin, si dhe për meshkujt dhe femrat, duke reflektuar një përfshirje të barabartë gjinore. Krahasuar me vitin paraprak, kur SHBR ishte 82.8%, vërehet një rritje prej 4.3 pikë përqindjeje.

1.2 Qasja në arsimin fillor

Treguesit në vijim pasqyrojnë nivelin e përgjithshëm të qasjes në klasën e parë dhe arsimin fillor, si dhe bëjnë krahasimin me treguesit e vendeve të rajonit dhe niveleve evropiane.


Figura 5: Shkalla e pranimit të nxënësve fillestarë



Shkalla e pranimit të nxënësve fillestarë në vitin shkollor 2024/2025 është 98.1%. Krahasuar me vitin 2023/2024, kur shkalla ishte 96.6%, kjo përfaqëson një rritje prej 1.5 pikë përqindjeje.

1.3 Pjesëmarrja në arsimin fillor


Figura 6: SHBR në arsimin fillor



Bazuar në të dhënat për vitin shkollor 2024/2025, shkalla bruto e regjistrimit (SHBR) në arsimin fillor është 96.2%. Krahasuar me vitin shkollor 2023/24, kur SHBR ishte 97.4%, kjo paraqet një rënie prej 1.2 pikë përqindjeje në përfshirjen e nxënësve në këtë nivel të shkollimit.

Në arsimin fillor, statistikën e SHBR për vitin shkollor 2024/25 renditin Republikën e Kosovës në mesin e shteteve të paraqitura në grafikon.

Figura 7: SHBR në arsimin fillor, krahasim (viti shkollor 2024-2025)




Burimi: MASHTI/SMIA për të dhënat e Kosovës (viti 2024), ndërsa për vendet e tjera të dhënat janë marrë nga UNESCO (viti 2025) për vitin 2023.

1.4 Pjesëmarrja në arsimin e mesëm të ulët


Për pjesëmarrjen në arsimin e mesëm të ulët është matur shkalla bruto e regjistrimit (SHBR) në këtë nivel, ndërsa është bërë edhe krahasimi i Republikës së Kosovës me Evropën dhe vendet e rajonit.

Figura 8: SHBR në arsimin e mesëm të ulët



Shkalla bruto e regjistrimit (SHBR) në arsimin e mesëm të ulët për vitin shkollor 2024/2025 është 94.3%. Krahasuar me vitin shkollor 2023/24, kur SHBR ishte 94.1%, kjo tregon një rritje të lehtë prej 0.2 pikë përqindjeje në përfshirjen e nxënësve në këtë nivel arsimor.

Figura 9: SHBR në arsimin e mesëm të ulët, krahasim (viti shkollor 2024-2025)




Burimi: Të dhënat për Kosovën janë marrë nga MASHTI/SMIA (viti 2024), ndërsa për vendet tjera të dhënat janë siguruar nga UNESCO (viti 2025) për vitin 2023.

1.5 Pjesëmarrja në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët


Në arsimin e obligueshëm (klasat 1-9) përfshihen të dhënat për arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët, sic tregohet në grafikonin në vijim.

Figura 10: SHBR në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët



Shkalla bruto e regjistrimit (SHBR) në arsimin e obligueshëm (klasa 1-9) për vitin shkollor 2024/25 është 95.4%. Krahasuar me vitin shkollor 2023/24, kur SHBR ishte 95.9%, kjo paraqet një rënie prej 0.5 pikë përqindjeje në përfshirjen e nxënësve.

Figura 11: SHBR në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët, krahasim (viti shkollor 2024-2025)




Burimi: Të dhënat për Kosovën janë marrë nga MASHTI/SMIA (viti 2024), ndërsa për vendet e tjera të dhënat janë siguruar nga UNESCO (viti 2025) për vitin 2023

1.6 Pjesëmarrja në arsimin e mesëm të lartë


Në vijim paraqiten treguesit e përgjithshëm të pjesëmarrjes së nxënësve në arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-12), të llogaritur shkallen bruto të regjistrimit me (SHBR), si raport ndërmjet nxënësve të regjistruar në këtë nivel dhe të popullatës së moshës 15-17 vjeçare për vitin 2024.

Figura 12: SHBR në arsimin e mesëm të lartë



Shkalla bruto e regjistrimit (SHBR) në arsimin e mesëm të lartë (klasa 10-12) për vitin shkollor 2024/25 është 86.4%.

Figura 13: SHBR në arsimin e mesëm të lartë, krahasim (viti shkollor 2024-2025)




Burimi: Të dhënat për Kosovën janë marrë nga MASHTI/SMIA (viti 2024), ndërsa për vendet e tjera të dhënat janë siguruar nga UNESCO (viti 2025) për vitin 2023.

1.7 Pjesëmarrja në arsimin e mesëm të lartë - profesional, sipas fushës

Fushat e arsimit dhe aftësimit, sipas klasifikimit ISCED-F 2013, kategorizojnë programet arsimore në përputhje me fushat e studimit, të cilat përkufizohen si “fusha, degë ose zona të gjera të përmbajtjes që mbulohen nga një program arsimor” (UIS, 2014, f. 5).

Figura 14: Nxënës të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë-Profesional sipas ISCED-F fushës së studimit.




Në vitin shkollor 2024/25, përfshirja e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë profesional dominohet nga inxhinieria, prodhimi dhe ndërtimtaria (29.7%), shëndeti dhe mirëqenia (26.2%). Pasohen nga biznesi, administrata dhe drejtësia (22.1%), teknologjia dhe TIK (11.4%). Fushat tjera kanë përfshirje më të ulët: artet dhe shkencat humanitare (4.5%), bujqësia (2.4%), shërbimet (3.0%).

1.8 Fëmijët jashtë shkollës

Për shkak të mungesës së të dhënave statistikore mbi moshën e nxënësve që ndjekin shkollën sipas niveleve, dhe si domosdoshmëri për llogaritjen e treguesit për fëmijët jashtë shkollës, është bërë një vlerësim i përafërt i këtij treguesi.

Ky vlerësim është kryer duke u bazuar në shkallën bruto të regjistrimit në arsimin e obligueshëm (klasat 1–9).

Figura 15: Fëmijët jashtë shkollës në arsimin e obliguar



Për vitin shkollor 2024/25, përqindja e fëmijëve jashtë shkollës në arsimin e obligueshëm (klasat 1–9) është 4.6%. Krahasuar me vitin shkollor 2023/24, kur ky tregues ishte 4.1%, vërehet një rritje prej 0.5 pikë përqindjeje në numrin e fëmijëve që nuk janë të përfshirë në arsimin e obligueshëm.


2. Kushtet e mësimnxënies

Treguesit e paraqitur në këtë kaptinë i referohen arsimit publik.

2.1 Raporti nxënës-mësimdhënës

Raporti nxënës–mësimdhënës është një tregues që mat nivelin e burimeve njerëzore në arsim, duke pasqyruar numrin e nxënësve në raport me numrin e mësimdhënësve. Ky tregues llogaritet duke pjesëtuar numrin e nxënësve të regjistruar në një nivel arsimor me numrin e mësimdhënësve të punësuar në atë nivel.

Figura 16: Raporti nxënës-mësimdhënës




Raporti nxënës–mësimdhënës për vitin shkollor 2024/25 tregon ndryshime të lehta krahasuar me vitin 2023/24 në të gjitha nivelet e arsimit publik. Në arsimin parashkollor, raporti është rritur nga 9.4 në 11.8. Në arsimin parafillor, raporti ka rënë nga 16.0 në 14.6. Për arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët, raporti ka shënuar një ulje të vogël – nga 13.0 në 12.6. Ndërsa në arsimin e mesëm të lartë, raporti ka rënë nga 12.0 në 11.6.

Sipas raportimeve të shkollave, raporti i nxënësve për kompjuter është 19.9, që do të thotë se mesatarisht ka një kompjuter për rreth 20 nxënës. Ky tregues shërben si një të dhënë statistikore për vlerësimin e pajisjeve teknologjike në shkolla.

2.2 Raporti nxënës-paralele

Grafikoni në vazhdim paraqet numrin e nxënësve për paralele sipas niveleve të arsimit parauniversitar.

Figura 17: Raporti nxënës-paralele




Raporti nxënës–paralele për vitin shkollor 2024/25 paraqet ndryshime të lehta krahasuar me vitin 2023/24. Në arsimin parashkollor, raporti ka rënë nga 9.5 në 9.3. Në arsimin parafillor, raporti ka rënë nga 16.0 në 14.6. Në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, raporti është zvogëluar nga 16.9 në 16.0. Ndërsa në arsimin e mesëm të lartë, raporti ka rënë nga 20.2 në 19.6.

2.3 Përqindja e mësimeve të femrave

Përqindja e mësimeve të femrave në strukturën e përgjithshme të personelit arsimor ka shfaqur një trend rritës vit pas viti në arsimin e obliguar dhe në arsimin e mesëm të lartë, ndërsa në nivelet parashkollor dhe parafillor përfshirja e tyre arrin pothuajse 100%.

Figura 18: Përqindja e mësimeve të femrave




Përqindja e mësimeve të femrave në vitin shkollor 2024/25 mbetet e qëndrueshme në shumicën e niveleve krahasuar me vitin 2023/24. Në arsimin parashkollor përqindja mbetet

99%, ndërsa në arsimin parafillor vazhdon të jetë 100%. Në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, përqindja e mësimdhënësve femra mbetet e pandryshuar, 65%. Ndërsa në arsimin e mesëm të lartë, vërehet një rritje e lehtë – nga 45% në vitin 2023/24 në 47% në vitin 2024/25.

2.4 Indeksi i barazisë gjinore

Në këtë kapitull paraqitet indeksi i barazisë gjinore për secilin nivel arsimor. Ky indeks mat përparimin drejt barazisë gjinore në pjesëmarrjen e fëmijëve/nxënësve në arsim. Indeksi llogaritet si raport ndërmjet vlerës së indikatorit (në këtë rast, SHBR) të llogaritur për femra dhe vlerës së të njëjtit indikator të llogaritur për meshkuj.

Figura 19: Indeksi i barazisë gjinore për SHBR




Indeksi i barazisë gjinore është përmirësuar nga viti 2023/24 në 2024/25: parashkollor 0.98 → 1.04, parafillor 0.97 → 1.00, fillor dhe mesëm i ulët 0.99 → 1.03, dhe arsimi i mesëm i lartë 1.07 → 1.10, duke treguar përparim të vazhdueshëm drejt barazisë gjinore në të gjithë nivelet e arsimit.

3. Efikasiteti i brendshëm

3.1. Raporti i nxënësve që fillojnë klasën e parë dhe arrijnë në klasën e pestë në arsimin fillor

Ky tregues pasqyron shkallën e përfundimit të arsimit fillor duke treguar raportin ndërmjet numrit të nxënësve të regjistruar në klasën e pestë për vitin shkollor 2024-2025 dhe numrit të nxënësve që filluan klasën e parë katër vjet më parë, në vitin shkollor 2021-2022.

Figura 20: Raporti i nxënësve që fillojnë klasën e parë dhe arrijnë në klasën e pestë të arsimit fillor




Raporti i nxënësve që fillojnë klasën e parë dhe arrijnë në klasën e pestë ka shënuar një rënie të lehtë, nga 90.1% në vitin shkollor 2023/24 në 89.5% në vitin 2024/25.

3.2. Raporti i nxënësve që fillojnë klasën e gjashtë dhe arrijnë në klasën e nëntë të arsimit të mesëm të ulët

Treguesi në vazhdim pasqyron shkallën e kalimit në arsimin e mesëm të ulët. Ai tregon raportin ndërmjet numrit të nxënësve të regjistruar në klasën e fundit të këtij niveli (klasën e nëntë) për vitin shkollor 2024-2025 dhe numrit të nxënësve që filluan klasën e gjashtë tre vite më parë, në vitin shkollor 2021-2022.

Figura 21: Raporti i nxënësve që fillojnë klasën e gjashtë dhe arrijnë në klasën e nëntë në arsimin e mesëm të ulët




Raporti i nxënësve që fillojnë klasën e gjashtë dhe arrijnë në klasën e nëntë në arsimin e mesëm të ulët ka shënuar një rënie të lehtë, nga 92.4% në vitin shkollor 2023/24 në 91.8% në vitin 2024/25.

3.3. Shkalla e kalimit (mbijetesës) sipas klasave në arsimin fillor

Shkalla e kalimit sipas klasave është një tregues i efikasitetit të brendshëm që tregon përqindjen e nxënësve të regjistruar në klasën e parë të një niveli arsimor në një vit të caktuar shkollor, të cilët pritet të kalojnë me sukses secilën klasë të atij niveli, pavarësisht nëse përsërisin ndonjë klasë gjatë rrugës.

Figura 22: Shkalla e kalimit sipas klasave (mbijetesës) në arsimin fillor




Shkalla e kalimit në arsimin fillor tregon një rënie të lehtë nga klasa e parë në klasën e pestë: 2023/24 (100%, 96.2%, 93.4%, 91.8%, 90.0%) dhe 2024/25 (100%, 95.5%, 93.1%, 91.0%, 88.0%).

3.4. Përsëritësit në arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë


Shkalla e përsëritjes tregon raportin ndërmjet numrit të nxënësve që përsërisin një klasë në vitin shkollor pasues dhe numrit të nxënësve të të njëjtës gjeneratë që ishin regjistruar në klasën e njëjtë në vitin paraprak.

Figura 23: Shkalla e përsëritjes në arsimin e mesëm të ulët



Shkalla e përsëritjes në arsimin e mesëm të ulët ka shënuar ndryshime të lehta nga viti 2023/24 në 2024/25. Përkatësisht, në klasën e gjashtë ka rënë nga 0.59% në 0.55%, në klasën e shtatë nga 0.54% në 0.49%, në klasën e tetë është rritur nga 0.48% në 0.65%, dhe në klasën e nëntë ka rënë nga 0.14% në 0.22%.

Figura 24: Shkalla e përsëritjes në arsimin e mesëm të lartë




Shkalla e përsëritjes në arsimin e mesëm të lartë ka shënuar një ulje të lehtë nga viti 2023/24 në 2024/25. Në klasën e dhjetë, shkalla ka rënë nga 1.15% në 1.03%, në klasën e njëmbëdhjetë nga 0.28% në 0.63%, dhe në klasën e dymbëdhjetë nga 0.12% në 0.23%.

3.5. Shkalla e tranzicionit nga arsimi fillor në atë të mesëm të ulët

Shkalla e tranzicionit tregon përqindjen e nxënësve që kalojnë nga një nivel arsimor në nivelin e ardhshëm. Ajo llogaritet si raporti ndërmjet numrit të nxënësve të pranuar në vitin e parë të nivelit më të lartë të arsimit dhe numrit të nxënësve të regjistruar në klasën e fundit të nivelit më të ulët të arsimit në vitin paraprak.


Figura 25: Shkalla e tranzicionit nga arsimi fillor në atë të mesëm të ulët



Shkalla e tranzicionit nga arsimi fillor në arsimin e mesëm të ulët ka shënuar një rënie të lehtë nga viti 2023/24 në 2024/25, duke kaluar nga 97.9% në 97.1%. Kjo tregon se pjesa më e madhe e nxënësve vazhdojnë rrjedhshëm nga arsimi fillor në atë të mesëm të ulët, me një ndryshim të vogël nga një vit në tjetrin.

3.6. Shkalla e tranzicionit nga arsimi i mesëm i ulët në atë të mesëm të lartë

Figura 26: Shkalla e tranzicionit nga arsimi i mesëm i ulët në atë të mesëm të lartë




Shkalla e tranzicionit nga arsimi i mesëm i ulët në arsimin e mesëm të lartë ka shënuar një rënie të lehtë nga viti 2023/24 në 2024/25, duke u ulur nga 96.3% në 95.3%. Kjo tregon se

pjesa më e madhe e nxënësve vazhdojnë rrjedhshëm në nivelin e ardhshëm arsimor, me një ndryshim të vogël nga një vit në tjetrin.

3.7. Nxënësit braktisës në arsimin fillor

Treguesi i braktisjes në arsimin fillor tregon përqindjen e nxënësve që e kanë braktisur shkollën gjatë vitit shkollor. Ai llogaritet si raporti ndërmjet numrit të nxënësve që kanë braktisur arsimin fillor dhe numrit total të nxënësve të regjistruar në këtë nivel.

Figura 27: Përqindja e nxënësve që kanë braktisur arsimin fillor




Përqindja e nxënësve që kanë braktisur arsimin fillor ka shënuar një ulje nga viti 2023/24 në 2024/25, duke kaluar nga 0.09% në 0.04%. Kjo tregon se braktisja në këtë nivel mbetet jashtëzakonisht e ulët dhe është përmirësuar nga një vit në tjetrin.

3.8. Nxënësit braktisës në arsimin e mesëm të ulët

Ngjashëm me arsimin fillor, edhe në arsimin e mesëm të ulët përqindja e nxënësve që kanë braktisur shkollën llogaritet si raporti ndërmjet numrit të nxënësve që e kanë braktisur këtë nivel gjatë vitit shkollor dhe numrit total të nxënësve të regjistruar në arsimin e mesëm të ulët në të njëjtin vit.


Figura 28: Përqindja e nxënësve që kanë braktisur arsimin e mesëm të ulët



Përqindja e nxënësve që kanë braktisur arsimin e mesëm të ulët ka shënuar një ulje nga viti 2023/24 në 2024/25, duke kaluar nga 0.12% në 0.10%. Kjo tregon se braktisja në këtë nivel mbetet shumë e ulët dhe ka pasur një përmirësim të lehtë nga një vit në tjetrin.

3.9. Nxënësit braktisës në arsimin e mesëm të lartë

Figura 29: Përqindja e nxënësve që e kanë braktisur arsimin e mesëm të lartë



Përqindja e nxënësve që kanë braktisur arsimin e mesëm të lartë ka shënuar një ulje të lehtë nga viti 2023/24 në 2024/25, duke kaluar nga 1.69% në 1.68%, duke treguar një stabilitet të qëndrueshëm në mbajtjen e nxënësve në këtë nivel arsimi.

3.10. Rezultatet e testeve të vlerësimeve të jashtme

Vlerësimi të jashtëm të nxënësve në sistemin arsimor i kushtohet një rëndësi e veçantë, ndërsa rezultatet e këtyre vlerësimeve shërbejnë për të evidentuar trendet e përgjithshme të arsimit në vend.

Figura 30: Rezultatet e arritshmërisë sipas lëndëve nga testi i maturës për mësimin në gjuhën amtare, për afatin e qershorit dhe gushtit për vitin shkollor 2024-2025 (shprehur në përqindje)




Figura 31: Rezultatet e kalueshmërisë nga testi i maturës për afatin e qershorit dhe afatin e gushtit të vitit shkollor 2024-2025 (llogaritur në përqindje)





Figura 32: Rezultatet e arritshmërisë nga testi i klasës së 9-të në vitin shkollor 2024-2025 (shprehur në përqindje)




4. Burimet financiare

4.1. Shpenzimet publike në arsim


Treguesit e paraqitur në këtë kapitull pasqyrojnë investimet e Qeverisë dhe shpenzimet në arsim. Shpenzimet publike në arsim, si përqindje e Bruto Produktit Vendor (BPV), arritën në 4.3% në vitin 2024, që është e njëjtë me vitin paraprak. Ndërkaq, shpenzimet publike për arsim si përqindje e shpenzimeve totale të Qeverisë përbëjnë 14.1%, duke shënuar një rritje prej 0.6 pikësh përqindjeje krahasuar me vitin paraprak. Në krahasim me vendet e Evropës, kjo përqindje e shpenzimeve publike për arsim si përqindje e BPV është e ngjashme me përqindjet e paraqitura në grafikon.

Figura 33: Shpenzimet publike për arsim si përqindje BPV (krahasim)



Burimi: MASHTI /SMIA, për Kosovë i referohen viti 2024, ndërsa për vendet tjera të dhënave nga UNESCO (2025) për vitin 2023.

Figura 34: Shpenzimet publike për arsim si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme të Qeverisë (krahasim)



Të dhënat për Kosovë i referohen vitit 2024, ndërsa për vendet tjera u referohemi të dhënave nga UNESCO (2025) për vitin 2023.

Bibliografia

- Agjencia e Statisikave të Kosovës (ASK), *Regjistrimi i Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovës 2024*, Prishtinë, dhjetor 2024.
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Republika e Kosovës, Korniza e Treguesve të Arsimit, Prishtinë, 2019.
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Republika e Kosovës, *Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019/2020*, Prishtinë, qershor 2020.
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Republika e Kosovës, *Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021*, Prishtinë, qershor 2021.
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Republika e Kosovës, *Statistikat e Arsimit në Kosovë 2021/2022*, Prishtinë, qershor 2022.
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Republika e Kosovës, *Statistikat e Arsimit në Kosovë 2022/2023*, Prishtinë, qershor 2023.
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Republika e Kosovës, *Statistikat e Arsimit në Kosovë 2023/2024*, Prishtinë, qershor 2024.
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Republika e Kosovës, *Statistikat e Arsimit në Kosovë 2024-2025*, Prishtinë, qershor 2025.
- UNESCO – UIS, Statistikat e Arsimit [Tabelë]. Ekstraktuar nga <http://data.uis.unesco.org/?queryid=182> [Ekstraktuar më 05 nentor 2025]

Shtojca 1: Të dhënat statistikore

Tabela 1: Nxënësit sipas grupmoshave/ klasave në Kosovë 2024-2025

Klasë	Meshkuj	Femëra	Gjithsej
Grupa 1-2	1111	1073	2184
Grupa 2-3	1505	1465	2970
Grupa 3-4	2230	2131	4361
Grupa 4-5	2341	2139	4480
Grupa 5-6 - Parafillor	8361	7676	16037
Grupa 5-6 – Parashkollor (Çerdhe)	2097	1909	4006
Klasa 1	11703	11083	22786
Klasa 2	11753	11118	22871
Klasa 3	11952	11255	23207
Klasa 4	11908	11121	23029
Klasa 5	11989	11184	23173
Klasa 6	12146	11131	23277
Klasa 7	12441	11730	24171
Klasa 8	11902	11417	23319
Klasa 9	11700	10982	22682
Klasa 10	11632	11007	22639
Klasa 11	10145	10553	20698
Klasa 12	9849	10365	20214
Klasa 13	0	0	0
Gjithsej	156765	149339	306104

Shtojca 2: Vlerësimi i jashtëm

Tabela 2: Rezultatet e kalueshmërisë sipas lëndëve nga testi i maturës për mësimin në gjuhën shqipe, viti shkollor 2024-2025

Lënda	Afati i qershorit	Afati i gushtit
Gj. amtare	53.9	52.2
Gj. angleze	51.1	40.2
Matematikë	35.5	34.8
Fizikë	35.7	35.7
Kimi	44.1	27.1
Biologji	59.5	40.5
Informatikë	53.7	44.9
Gjeografi	52.2	42.6
Histori	52.3	38.6
Sociologji	45.3	44.3
Psikologji	41.9	38.6
Ekonomi me ndërm,	49.7	46.7
Edukatë qytetare	49.5	37.0
Histori e artit	38.3	33.4
Teori e m. dhe harm	49.3	41.0

Tabela 3: Rezultatet e kalueshmërisë nga testi i maturës për afatin e qershorit dhe afatin e gushtit, viti shkollor 2024-2025

Kalueshmëria	Afati i qershorit	Afati i gushtit
Gjithsej	67.9 %	54.4 %

Tabela 4: Rezultatet e testit të arritshmërisë sipas lëndëve, klasa e 9-të

Gj. amtare	Gj. angleze	Histori	Gjeografi	Matematikë	Informatikë	Fizikë	Kimi	Biologji	Totali
59.8	39.3	61.1	52.9	38.9	54.7	40.6	37.4	42.6	48.8

